



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.218

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i ERE nr.87, datë 6.8.2008	Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike	11739
Vendim i ERE nr.94, datë 14.8.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”.....	11742
Vendim i ERRU nr.3, datë 16.1.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Pogradec	11745
Vendim i ERRU nr.12, datë 29.5.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u. Delvinë	11746
Vendim i ERRU nr.15, datë 14.7.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u. Përmet	11746
Vendim i ERRU nr.20, datë 14.7.2008	Për pagesën e pajisjes me licencë	11747
Vendim i ERRU nr.25, datë 13.8.2008	Për miratimin e tarifave të grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura për sh.a.u.k. Kukës	11748
Vendim i ERRU nr.26, datë 25.8.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Lezhë	11748
Vendim i ERRU nr.27, datë 15.9.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Korçë	11749

Vendim i ERRU nr.29, datë 26.9.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Rubik	11749
Vendim i ERRU nr.33, datë 31.10.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Tiranë	11750
Vendim i ERRU nr.42, datë 4.12.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Fier	11750
Vendim i ERRU nr.46, datë 30.12.2008	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Kavajë	11751

VENDIM
Nr.87, datë 6.8.2008

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË
METODOLOGJISË TË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, pasi diskutoi mbi draftdeklaratën rregullatore të përgatitur nga ERE, në kuadër të zbatimit të metodologjive të vendosjes së tarifave të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë deklaratën rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të vendosjes së tarifave të energjisë elektrike. (Deklarata bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

DEKLARATË RREGULLATORE

Qëllimi

Kjo deklaratë rregullatore miratohet me qëllim që të bëjë të mundur llogaritjen e tarifave për veprimtaritë e gjenerimit publik, furnizimit publik me shumicë, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë, në zbatim të metodologjive të tarifave përkatëse të miratuara nga ERE.

Ajo do të zbatohet për 3 periudhat e para rregullatore, siç janë të përcaktuara në metodologjitë përkatëse të tarifave (1 mars 2009 deri në 28 shkurt 2010; 1 mars 2010 deri në 28 shkurt 2011 dhe 1 mars 2011 deri në 28 shkurt 2013). Me përfundimin e tri periudhave të para rregullatore, ERE do të miratojë një deklaratë rregullatore për periudhat e tjera rregullatore vijuese.

Për tarifën e kompanisë publike të prodhimit (KPP)

- Përcaktimi i vlerës së RAB-it të KPP-së për periudhën e parë rregullatore

Në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në, RAB-i i KPP-së për vitin 2009 do të llogaritet si shuma e vlerës kontabël të aseteve fikse, që rezultojnë nga bilanci i audituar, sipas standardeve IFRS të KPP-së në 31 dhjetor 2007, plus investimet, që janë vendosur në punë gjatë vitit kalendarik 2008, sipas bilancit të mbylljes së vitit 2008 ose investimeve të pritshme nga kompania për vitin 2008, plus investimet e parashikuara nga i licencuari për vitin 2009 dhe të pranuar nga ERE, minus amortizimin e akumuluar për vitin 2009.

- Përcaktimi i normës së kthimit nga kapitali i vet (RoE) për KPP-në

Duke qenë se KPP do të mbetet në pronësi të shtetit, ajo do të ketë një profil risku financimi të ulët. Për më tepër qeveria nuk kërkon kthime të larta nga kapitali i vet. Për këtë arsye RoE për KPP-në nuk është një normë kthimi e bazuar në treg, por përcaktohet si një përqindje interesi e bonove të thesarit afatshkurtra të Bankës së Shqipërisë.

- Raporti i synuar i borxhit ndaj kapitalit total për KPP-në

Ky raport pranohet të jetë 60% borxh për tri periudhat e para rregullatore.

- Kapitali i punës i pranuar nuk do të jetë më tepër se 1/12 e OPEX (Shpenzimeve operative), siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në.

- Niveli vjetor i prodhimit hidro të KPP-së

Mesatarja vjetore e prodhimit hidro për 10 vitet e fundit është 4579 GWh, ndërsa për 5 vitet e

fundit është 4770 GWh. Duke marrë në konsideratë faktin që KESH-i përdor nivelin 4200 GWh prodhim hidro për parashikimin vjetor të prodhimit, është e mundur që prodhimi faktik të jetë rreth 2500 GWh më i lartë se prodhimi i parashikuar nga KESH-i në 3 periudhat e para rregullatore, duke siguruar kështu qëndrueshmëri të tarifave në të ardhmen dhe lehtësim të riskut hidrologjik.

Për llogaritjen e tarifave që FPSH-ja do të aplikojë për FPP-në dhe që KPP-ja do të aplikojë për OST-në, prodhimi vjetor hidro i KPP-së për tri periudhat e para rregullatore do të pranohet 4200 GWh prodhim neto në vit.

Për tarifën e furnizuesit publik me shumicë (FPSH)

- Norma e fitimit për furnizuesin publik me shumicë do të jetë e barabartë me 0.5% mbi blerjet vjetore të energjisë elektrike.

- Për të ulur risqet e FPSH-së, që bunojnë nga prodhimi hidro i KPP-së, do të bëhen axhustimet vjetore të mëposhtme:

i) Tarifa e FPSH-së do të përfshijë edhe kosto financiare neto, që i shkaktohen FPSH-së nga risku i sipërpërmendur .

ii) Axhustime për të mbuluar koston e interesit për të mbajtur një linjë kredie të marrë për vitet e thata hidrike.

iii) Axhustime vjetore do të bëhen për tepricat ose mungesat e të ardhurave për KPP-në, që rrjedhin nga ndyshimet në prodhimin hidro nga prodhimi i planifikuar prej 4200 GWh/vit të vitit paraardhës.

- FPSH-ja do të bëjë një tender vjetor në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” për blerjet me shumicë të energjisë elektrike shtesë mbi prodhimin e parashikuar të KPP-së.

Për tarifën e shërbimit të shpërndarjes

- Përcaktimi i vlerës së RAB-it për periudhën e parë rregullatore për OSSH-në

Vlera fillestare e RAB-it për periudhën e parë rregullatore do të jetë e barabartë me vlerën kontabël të asetëve fikse, që rezultojnë nga bilanci i audituar sipas standardeve IFRS të OSSH-së më 31 dhjetor 2007, plus investimet, që janë vendosur në punë gjatë vitit kalendarik 2008, sipas bilancit të mbylljes së vitit 2008 ose investimeve të pritshme nga kompania për vitin 2008, plus investimet e parashikuara nga i licencuari për vitin 2009 dhe të pranuar nga ERE, minus amortizimin e akumuluar për vitin 2009.

Asetet fikse do të përfshijnë të gjitha asetet afatgjata materiale dhe jomateriale që përdoren për të ofruar shërbimin e shpërndarjes. ERE do të përfshijë nga vlera e RAB-it asetet afatgjata materiale dhe jomateriale të financuara nëpërmjet granteve.

Axhustimi i RAB-it për vitet e ardhshme do të bëhet në përputhje me metodologjinë e tarifave të shpërndarjes. Kjo metodë reflekton në mënyrë të drejtë investimet fillestare të bëra nga investitori, të cilat duhet të rikthehen nëpërmjet kthimit mbi RAB-in.

- Llogaritjet e koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) për OSSH-në

WACC-u i pranuar nga ERE për 3 periudhat e para rregullatore do të llogaritet mbi baza vjetore siç është shprehur më poshtë.

RoE para takse për OSSH-në është 12%.

Kosto e borxhit të ri e pranuar nga ERE për OSSH-në do të jetë kosto aktuale, por jo më e lartë se norma mesatare e interesit të tregut të brendshëm të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Kosto e borxhit për borxhet e vjetra është kosto aktuale e aplikuar sipas termave të marrëveshjes së nënhuasë midis KESH-it dhe OSSH-së.

Borxhi i vjetër i referohet borxheve, që i janë ngarkuar OSSH-së, në përputhje me marrëveshjen e nënhuasë së saj me KESH-in.

WACC llogaritet si më poshtë:

$$\text{RoE} \% * \text{Eq} / \text{Total Cap} = \text{Y1} \%$$

$$\text{CoOD} \% * \text{OldL}_T / \text{Total Cap} = \text{Y2} \%$$

$$\text{CoND} \% * \text{NewL}_T / \text{Total Cap} = \text{Y3} \%$$

$$\text{WACC} = \text{Y1} \% + \text{Y2} \% + \text{Y3} \%$$

Ku:

RoE% = Norma e kthimit mbi kapitalin e vet;

CoOD% = Norma mesatare aktuale e interesit të borxheve të vjetra;

CoND% = Norma mesatare e interesit të borxheve të reja;

Eq/Total Cap = Pjesa e kapitalit të vet në totalin e kapitalit;

OIdL-T/Total Cap = Pjesa e borxhit të vjetër afatgjatë në totalin e kapitalit;

NewL-T/Total Cap = Pjesa e borxhit të ri afatgjatë në totalin e kapitalit.

- Raporti i synuar i borxhit ndaj totalit të kapitalit për OSSH-në:

Ky raport pranohet të jetë 60% borxh për tri periudhat e para rregullatore.

- Kapitali i punës i pranuar nuk do të jetë më tepër se 1/12 e OPEX-it (Shpenzimeve operative) siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për OSSH-në.

- Për të përcaktuar tarifën e vitit 2009 do të merret në konsideratë niveli i pritshëm i humbjeve për vitin 2008 i barabartë me 32% të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes. N.q.s. rezultati për vitin 2008 do të jetë më i madh se niveli i pritshëm (prej 32%), OSSH-ja do të kompensohet në periudhën e dytë rregullatore.

Deri tani nuk ka ndonjë studim specifik për humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Për qëllime të llogaritjes së tarifës bazuar në përllogaritjet e KESH-it, ERE pranon humbjet teknike të barabarta me 18%.

ERE pret përmirësim të shpejtë në nivelin e humbjeve joteknike dhe një përmirësim më të ngadaltë, por të vazhdueshëm në reduktimin e humbjeve teknike. Humbjet joteknike do të reduktohen si më poshtë:

5% reduktim për periudhën e parë rregullatore;

3% reduktim për periudhën e dytë rregullatore;

6% reduktim për periudhën e tretë rregullatore.

Gjatë vitit 2009, OSSH do të kryejë një studim të detajuar të humbjeve dhe do t'i propozojë ERE-s një program për reduktimin e humbjeve teknike për periudhën e dytë dhe të tretë rregullatore, të ndarë sipas viteve të shoqëruar me planin e investimeve për reduktimin e humbjeve sipas këtij programi. ERE do të miratojë nivelin e investimeve për reduktimin e humbjeve sipas programit të paraqitur nga OSSH-ja.

- Faktori X

Vlera e faktorit X për dy periudhat e para rregullatore (2009 dhe 2010) do të jetë zero, dhe 1 % për çdo vit të periudhës së tretë rregullatore. Për dy periudhat e para rregullatore, ERE do t'i lërë hapësirë OSSH-së në lidhje me masat që do të ndërmerren për një përmirësim në efikasitet të operacioneve ditore të saj. Për periudhën e tretë rregullatore pritet një përmirësim i vogël i efikasitetit.

- ERE do ta përdorë çmimin mesatar vjetor të importit të energjisë elektrike të vitit paraardhës të realizuar nga FPSH-ja si çmim të pranuar për llogaritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve totale. Çmimi i vlerësuar i FPSH-së do të shumëzohet me humbjet totale të pranuar nga ERE. Për tarifën e furnizuesit publik me pakicë (FPP)

- Tarifa e FPSH-së do të jetë kosto e njohur për FPP-në.

- Norma e fitimit për furnizuesin publik me pakicë do të jetë e barabartë me 1 % mbi blerjet e saj vjetore të energjisë elektrike.

- Nuk do të lejohet "Borxh i keq".

Cilësia e shërbimit të furnizimit me energji elektrike

ERE nuk ka caktuar ende standardet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike. ERE do t'i përgatisë dhe do t'i miratojë këto standarde deri në fund të vitit 2008. Deri atëherë, ERE do të pranojë:

- Ndërprerje të furnizimit me energji elektrike (me shpeshtësi dhe kohëzgjatje) në, raste riparimesh dhe remontesh që do të kryhen nga OSSH-ja. OSSH-ja duhet t'i paraqesë ERE-s programin e remonteve mbi baza vjetore.

- Saktësi të fakturimit 99 %. Saktësia e fakturimit është kritike për të reduktuar humbjet dhe për të qenë të drejtë ndaj konsumatorëve. Për më tepër ERE dhe OSSH-ja/FPP-ja, duhet të punojnë së bashku për të vendosur rregulla për shpeshtësinë e leximit të matësve dhe se si do të ndahet konsumi i energjisë elektrike për çdo muaj në rastet kur një matës lexohet më rrallë se një herë në muaj.

Dispozita përfundimtare
Në të gjitha dokumentet zyrtare të miratuara nga ERE versioni shqip i këtij dokumenti është versioni zyrtar.
Miratimi
Kjo deklaratë rregullatore u miratua nga Bordi i Komisionerëve me vendimin nr.87, datë 6.8.2008.

VENDIM
Nr.94, datë 14.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.87, DATË 6.8.2008 “PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË METODOLOGJIVE TË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.8.2008, në kuadër të zbatimit të metodologjive të vendosjes së tarifave të energjisë elektrike, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në deklaratën rregullatore të miratuar me vendimin nr.87, datë 6.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”.
2. Deklarata rregullatore me ndryshimet përkatëse i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

DEKLARATË RREGULLATORE

Qëllimi

Kjo deklaratë rregullatore miratohet me qëllim që të bëjë të mundur llogaritjen e tarifave për veprimtaritë e gjenerimit publik, furnizimit publik me shumicë, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë në zbatim të metodologjive të tarifave përkatëse të miratuara nga ERE.

Ajo do të zbatohet për periudhat rregullatore të përcaktuara si më poshtë:

- Viti 2009 përfaqëson një periudhë rregullatore tranzitore gjatë së cilës do të ruhen parametrat ekzistues rregullatorë. ERE do të pranojë një periudhë nga 1 janari-1qershor 2009, gjatë së cilës

investitori do të ketë mundësi të njihet me aktivitetin e OSSH-së dhe terrenin ku do të operojnë. Më 1 qershor 2009 OSSH-ja do të aplikojë për rishikimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes dhe të shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Tarifat e reja do të hyjnë në fuqi me 1 janar 2010 dhe do të marrin në konsideratë çdo diferencë që do të krijohet në të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2009 krahasuar me atë të pritshme.

- Periudha e parë rregullatore do të jetë 1 janar-31 dhjetor 2010;
- Periudha e dytë rregullatore do të jetë 1 janar-31 dhjetor 2011;
- Periudha e tretë rregullatore do të jetë 1 janar 2012- 31 dhjetor 2014.

Me përfundimin e tri periudhave të para rregullatore, ERE do të miratojë një deklaratë rregullatore për periudhat e tjera rregullatore në vijim.

Për tarifën e kompanisë publike të prodhimit (KPP)

- Përcaktimi i vlerës së RAB-it të KPP-së për vitin 2009

Në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në, RAB-i i KPP-së për vitin 2009 do të llogaritet si shuma e vlerës kontabël të aseteve fikse, që rezulton nga bilanci i audituar, sipas standardeve IFRS të KPP-së në 31 dhjetor 2007, plus investimet e pritshme nga kompania për vitin 2008, plus investimet e parashikuara nga i licencuari për vitin 2009 dhe të pranuar nga ERE, minus amortizimin e akumuluar për vitin 2009.

- Përcaktimi i normës së kthimit nga kapitali i vet (RoE) për KPP-në

Duke qenë se KPP-ja do të mbetet në pronësi të shtetit, ajo do të ketë një profil risku financimi të ulët. Për më tepër qeveria nuk kërkon kthime të larta nga kapitali i vet. Për këtë arsye RoE për KPP-në nuk është një normë kthimi e bazuar në treg, por përcaktohet si një përqindje interesi e bonovo të thesarit afatshkurtra të Bankës së Shqipërisë.

- Raporti i synuar i borxhit ndaj kapitalit total për KPP-në

Për qëllim të llogaritjes së tarifës së prodhimit të energjisë elektrike, ky raport pranohet të jetë 60% borxh.

- Kapitali i punës i pranuar nuk do të jetë më tepër se 1/12 e OPEX (Shpenzimeve operative), siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në.

- Niveli vjetor i prodhimit hidro të KPP-së

Mesatarja vjetore e prodhimit hidro për 10 vitet e fundit është 4579 GWh, ndërsa për 5 vitet e fundit është 4770 GWh. Duke marrë në konsideratë faktin që KESH-i përdor nivelin 4200 GWh prodhim hidro për parashikimin vjetor të prodhimit, është e mundur që prodhimi faktik të jetë rreth 2500 GWh më i lartë se prodhimi i parashikuar nga KESH-i për 5 vitet e ardhshme, duke siguruar kështu qëndrueshmëri të tarifave në të ardhmen dhe minimizim të riskut hidrologjik.

Për llogaritjen e tarifave që FPSH-ja do të aplikojë për FPP-në dhe që KPP-ja do të aplikojë për OST-në, prodhimi vjetor hidro i KPP-së për periudhat rregullatore të përcaktuara në këtë deklaratë do të pranohet 4200 GWh prodhim neto në vit.

Për tarifën e furnizuesit publik me shumicë (FPSH)

- Norma e fitimit për furnizuesin publik me shumicë do të jetë a barabartë me 0.5% mbi blerjet vjetore të energjisë elektrike.

- Për të ulur risqet e FPSH-së, që burijnë nga prodhimi hidro i KPP-së, do të bëhen axhustimet vjetore të mëposhtme:

i) Tarifa e FPSH-së do të përfshijë edhe kosto financiare neto, që i shkaktohen FPSH-së nga risku i sipërpërmendur.

ii) Axhustime për të mbuluar koston e interesit për të mbajtur një linjë kredie të marrë për vitet e thata hidrike.

iii) Axhustime vjetore do të bëhen për tepricat ose mungesat e të ardhurave për KPP-në, që rrjedhin nga ndyshimet në prodhimin hidro nga prodhimi i planifikuar prej 4200 GWh/vit të vitit paraardhës.

- FPSH-ja do të bëjë një tender vjetor në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” për blerjet me shumicë të energjisë elektrike shtesë mbi prodhimin e parashikuar të KPP-së. Për tarifën e shërbimit të shpërndarjes

- Përcaktimi i vlerës së RAB-it për OSSH-në

Vlera fillestare e RAB-it për vitin 2009 do të jetë e barabartë me vlerën kontabël të aseteve fikse, që rezulton nga bilanci i audituar sipas standardeve IFRS të OSSH-së më 31 dhjetor 2007, plus investimet e pritshme nga kompania për vitin 2008, plus investimet a parashikuara nga i licencuari për

vitin 2009 dhe të pranuar nga ERE, minus amortizimin e akumuluar për vitin 2009.

Asetet fikse do të përfshijnë të gjitha asetet afatgjata materiale dhe jomateriale që përdoren për të ofruar shërbimin e shpërndarjes. ERE do të përjashtojë nga vlera e RAB-it asetet afatgjata materiale dhe jomateriale të financuara nëpërmjet granteve.

Axhustimi i RAB-it për vitet e ardhshme do të bëhet në përputhje me metodologjinë e tarifave të shpërndarjes. Kjo metodë reflekton në mënyrë të drejtë investimet fillestare të bëra nga investitori, të cilat duhet të rikthehen nëpërmjet kthimit mbi RAB-in.

- Llogaritjet e koston mesatare të ponderuar të kapitait (WACC) për OSSH-në

Për qëllim të llogaritjes së tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, WACC-u i pranuar nga ERE do të llogaritet mbi baza vjetore siç është shprehur më poshtë.

RoE para takse për OSSH-në është 12%.

Kosto e borxhit të ri e pranuar nga ERE për OSSH-në do të jetë kosto aktuale, por jo më e lartë se norma mesatare e interesit të tregut të brendshëm të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Kosto e borxhit për borxhet e vjetra është kosto aktuale e aplikuar sipas termave të marrëveshjes së nënhuasë midis KESH-it dhe OSSH-së.

Borxhi i vjetër u referohet borxheve, që i janë ngarkuar OSSH-së në përputhje me marrëveshjen e nënhuasë së saj me KESH-in.

WACC llogaritet si më poshtë:

$RoE\% * Eq / Total\ Cap = Y1\%$

$CoOD\% * OldL_T / Total\ Cap = Y2\%$

$CoND\% * NewL_T / Total\ Cap = Y3\%$

$WACC = Y1\% + Y2\% + Y3\%$

Ku:

RoE% = Norma e kthimit mbi kapitalin e vet;

CoOD% = Norma mesatare aktuale e interesit të borxheve të vjetra;

CoND% = Norma mesatare e interesit të borxheve të reja;

$Eq / Total\ Cap$ = Pjesa e kapitalit të vet në totalin e kapitalit;

$OldL_T / Total\ Cap$ = Pjesa e borxhit të vjetër afatgjatë në totalin e kapitalit;

$NewL_T / Total\ Cap$ = Pjesa e borxhit të ri afatgjatë në totalin e kapitalit.

- Raporti i synuar i borxhit ndaj totalit të kapitalit për OSSH-në:

Për qëllim të llogaritjes së tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ky raport pranohet të jetë 60%.

- Kapitali i punës i pranuar nuk do të jetë më tepër se 1/12 e OPEX-it (Shpenzimeve operative), siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për OSSH-në.

- Për të përcaktuar objektivat e reduktimit të humbjeve përgjatë periudhave rregullatore do të merret në konsideratë niveli i pritshëm i humbjeve për vitin 2008 i barabartë me 32% të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes. Deri tani nuk ka ndonjë studim specifik për humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Për qëllime të llogaritjes së tarifës bazuar në përlllogaritjet e KESH-it, ERE pranon për periudhën e tretë rregullatore humbjet e përgjithshme (teknike+joteknike) të barabarta me 15%.

ERE pret përmirësim të shpejtë në nivelin e humbjeve joteknike dhe një përmirësim më të ngadaltë, por të vazhdueshëm në reduktimin e humbjeve teknike. ERE parashikon zvogëlimin e humbjeve totale në shpërndarje sipas një skenari të tillë:

- 4% reduktim për periudhën e parë rregullatore;

- 4% reduktim për periudhën e dytë rregullatore;

- 9% reduktim për periudhën e tretë rregullatore (3*3%).

Gjatë viti 2009, OSSH-ja do të kryejë një studim të detajuar të humbjeve totale. Në qoftë se skenarin e propozuar nga ERE nuk e konsideron të përshtatshme, OSSH do t'i propozojë ERE-s një program për reduktimin e humbjeve totale për tri periudhat rregullatore të përmendura më sipër, të ndara sipas viteve të shoqëruar me planin e investimeve për reduktimin e humbjeve sipas këtij programi. Niveli i investimeve për reduktimin e humbjeve, sipas programit të paraqitur nga OSSH-ja, miratohet nga ERE.

Dispozitat përfundimtare

Në të gjitha dokumentet zyrtare të miratuara nga ERE versioni shqip i këtij dokumenti është

versioni zyrtar.

Miratimi

Kjo deklaratë rregullatore u amendua nga Bordi i Komisionerëve, me vendimin nr.94, datë 14.8.2008.

VENDIM
Nr.3, datë 16.1.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK POGRADEC

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar me ligjin nr.9352, datë 3.3.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8102”, metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” dhe rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e ERRU-së”, në zbatim të këtij ligji,

Komisioni Kombëtar Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

VENDOSI:

1. T’i miratojë:

Emri i subjektit: sh.a.ujësjellës-kanalizime Pogradec

Zona e shërbimit: qyteti Pogradec, komuna Buçimas

Tarifat e ujit për konsum publik si më poshtë:

	për ujin e pijshëm	për ujërat e ndotura
Konsumatori familjar:	48 lekë/m ³	10 lekë/m ³
Institucionet buxhetore:	105 lekë/m ³	14 lekë/m ³
Entet private:	105 lekë/m ³	14 lekë/m ³

2. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.2.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

ZËVENDËSKRYETARE E ERRU-së
Aida Gojani

VENDIM
Nr.12, datë 29.5.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAU DELVINË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar me ligjin nr.9352, datë 3.3.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8102”, të metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit të pijshëm për konsum publik për sh.a.u. Delvinë, si më poshtë:

Konsumator familjar: 48 lekë/m³

Institucion buxhetore: 100 lekë/ m³
Ente private: 100 lekë/ m³
2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.15, datë 14.7.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR
SHAU PËRMET

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit të pijshëm për konsum publik për sh.a.u. Përmet, si më poshtë:
Konsumator familjar: 32 lekë/m³
Institucione buxhetore: 80 lekë/ m³
Ente private: 100 lekë/ m³
2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.8.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.20, datë 14.7.2008

PËR PAGESËN E PAJISJES ME LICENCË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.400, datë 19.8.1999 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....”Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Subjektet që mbulojnë një zonë shërbimi me popullsi deri në 10 000 banorë e operojnë vetëm në sektorin e furnizimit me ujë, të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa subjektet që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh.
2. Subjektet që mbulojnë një zonë shërbimi me popullsi nga 10 000 deri në 100 000 banorë, që operojnë vetëm në sektorin e furnizimit me ujë, të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, ndërsa subjektet që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 50 000 (pesëdhjetë

mijë) lekësh.

3. Subjektet që mbulojnë një zonë shërbimi me popullsi mbi 100 000 banorë e operojnë vetëm në sektorin e furnizimit me ujë të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh ndërsa subjektet që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekësh.

4. Subjektet që operojnë në sektorin e trajtimit të ujërave të ndotura të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 20 000 (njëzet mijë) lekë.

5. Drejtuesit teknikë që punojnë vetëm në sektorin e furnizimit me ujë të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 5000 (pesë mijë) lekë, ndërsa drejtuesit teknikë që punojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të paguajnë për licencimin e tyre një vlerë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.25, datë 13.08.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË GRUMBULLIMIT E LARGIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHAUK KUKËS

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura për sh.a.u.k. Kukës, si më poshtë:

Konsumator familjar: 7 lekë/m³

Institucione buxhetore: 15 lekë/ m³

Ente private: 20 lekë/ m³

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.9.2008 dhe është i vlefshëm deri më 1.9.2009.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.26, datë 25.8.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-t

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Lezhë, si më poshtë:

	për ujin e pijshëm	për ujin e ndotur
Konsumator familjar:	43 lekë/m ³	10 lekë/ m ³
Institucione buxhetore:	100 lekë/ m ³	14 lekë/ m ³
Ente private:	110 lekë/ m ³	17 lekë/ m ³

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.9.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.27, datë 15.9.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK KORÇË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Korçë, si më poshtë:

	për ujin e pijshëm:	për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	47 lekë/m ³	16.4 lekë/m ³
Institucione buxhetore:	80 lekë/ m ³	26 lekë/ m ³
Ente private:	105 lekë/ m ³	30 lekë/ m ³

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.10.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.29, datë 26.9.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK RUBIK

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI :

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Rubik, si më poshtë:

për ujin e pijshëm për ujërat e ndotura

Konsumator familjar:	30 lekë/m ³	7 lekë/ m ³
Institucione buxhetore:	70 lekë/ m ³	10 lekë/ m ³
Ente private:	100 lekë/ m ³	15 lekë/ m ³

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.10.2008 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.33, datë 31.10.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK TIRANË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik si më poshtë:

për ujin e pijshëm për ujërat e ndotura

Konsumator familjar:	20 lekë/m ³	5 lekë/ m ³
Institucione buxhetore:	75 lekë/ m ³	6 lekë/ m ³
Entet private:	95 lekë/ m ³	10 lekë/ m ³
Bashkia Kamëz (ujë me shumicë):	6 lekë/ m ³	
H/C Lanabregas (ujë me shumicë):	4.5 lekë/ m ³	

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.11.2008 dhe është i vlefshëm deri me miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.42, datë 4.12.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK FIER

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Fier, si më poshtë:

	për ujin e pijshëm	për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	38 lekë/m ³	7 lekë/ m ³
Institucione buxhetore:	70 lekë/ m ³	12 lekë/ m ³
Ente private:	90 lekë/ m ³	14 lekë/ m ³
ARMO,TEC,AZOTIK	50 lekë/ m ³	

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2009 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.46, datë 30.12.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK KAVAJË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit të pijshëm për konsum publik për sh.a.u.k. Kavajë, si më poshtë:

Konsumator familjar:	35 lekë/m ³
Institucione buxhetore:	68 lekë/ m ³
Ente private:	90 lekë/ m ³
Shitje ujë me shumicë (për sh.a.u.k Durrës):	29.8 lekë/ m ³

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2009 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU-së
Avni Dervishi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.3.2009
Doli nga shtypi më 18.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 16 lekë